



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1641 Prot.

Tiranë, më 30.06 2023

V E N D I M

Nr. 48 datë 30.06 2023

“PËR

MIRATIMIN E PAGAVE TË PUNONJËSVE NDIHMËS AKADEMIK ME
KARAKTER ADMINISTRATIV DHE ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN E
SPORTEVE TË TIRANËS”

Bordi i Administrimit të Universitetit Sporteve të Tiranës, mbështetur në:

- Ligjin nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”;
- VKM nr.123, datë 17.02.2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”;
- Ligji nr.10/247 “Për kornizën shqiptare të kualifikimeve”, të ndryshuar;
- Udhëzimin i Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Arsimit të Lartë”;
- Vendimin i Bordit të Administrimit nr.07, datë 01.02.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023, në Universitetin e Sporteve të Tiranës”;
- VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nënpunësëve civil dhe nënpunësve në disa institucione të administratës publike”.
- VKM nr. 326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa insitucione të administratës publike”;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr.16, datë 16.06.2023 “Për mënyrën e zbatimit të VKM nr.325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, dhe të niveleve të pagave nënpunësëve civil/nënpunësve, zëvendësministrit dhe nënpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të sugjerimit të MAS përcjell përmes e mail të datës 29.06.2023 dhe në Relacionin nr. 1682/1 prot, datë 30.06.2023, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkivë Protokollit dhe Drejtorisë së Finacës dhe Buxhetit të UST, në mblëdhjen e tij të datës 30.06.2023,

VENDOSI:

1. Miratimin e nivelit të pagave të stafit ndihmës akademik dhe administrative të Universitetit të Sporteve të Tiranës, sipas pasqyrës nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

PASQYRA 1. Niveli i pagave të stafit ndihmës akademik dhe administrativ të UST.

Nr Rendor	Pozicioni	Kategoria e pagës sipas VKM nr. 187/2017 (ishte)	Kategoria e pages sipas (VKM nr. 325/2023) Udhëzimit nr. 16 datë 16.06.2023 Rekomandimi	Paga e pozicionit referuar VKM nr. 187, datë 10.3.2017	Paga e pozicionit e ekuivalentur sipas Udhëzimit nr. 16.6.2023	Vlera e Pagës së Grupit (lekë/muaj)
1	Adminstrator në Universitet (NA)	II-b	II-1	107,000	155,000	14,000
2	Drejtor Drejtorie	III-a	III-1	86500	115,000	14,000
3	Përgjegjës sektori,	III-b	III-3	65200	95,000	14,000
4	Klasifikator dhe Kryebibliotekar në universitet, Specialist, Specialist në fakultet	IV-a	IV-2	52000	70,000	14,000

2. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme, të Universitetit të Sporteve të Tiranës, sipas pasqyrës nr.2, bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

PASQYRA 2. Niveli i pagave të punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme, të UST.

Nr.	Emërtimi i punonjësit	Niveli i pages Klasa (ishte)	Niveli i pages Klasa (behet)	Shkalla e vështirësisë së dëmshmërisë (ishte)	Shkalla e vështirësisë së dëmshmërisë (BËHET)
1	Llogaritar	VII	VI	Shkalla e I-rë dhe Shkalla e II-të.	Shkalla e I-rë dhe Shkalla e II-të.
2	Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme.	VI	V	Shkalla e I-rë dhe Shkalla e II-të.	Shkalla e I-rë dhe Shkalla e II-të.
3	Punonjës mirëmbajtje	IV	III	Shkalla e II-të dhe Shkalla e III-të.	Shkalla e II-të dhe Shkalla e III-të.
4	Punonjës pastrimi/sanitar	I-rë	I-rë	Shkalla e I-rë dhe Shkalla e II-të.	Shkalla e I-rë dhe Shkalla e II-të, III-të

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi; Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivë Protokollit, Drejtoria Juridike dhe e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të UST.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqesn www.ust.edu.al dhe tek Transparenca Universitare.

KRYETARË I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

ARTUR COBANI

